



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:360042

Datë: 06.01.2025

Numri i dokumentit: 06682120

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.468/24

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen penale kundër të akuzuarve A. B. dhe A. B., për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të *KPRK*-së, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5333/2024 të dt.29.11.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më datë 06.01.2025, në praninë e Prokurorit të Shtetit Dardan Çela, përfaqësuesit të palës së dëmtuar B. K. dhe të pandehurve në të njëjtën ditë mori publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

- A. B.** nga babi S. dhe nëna H., mbiemri i vajzërisë se nenës O. i lindur më në B. komuna e P., ka të kryer shkollën fillore, i pamartuar, i gjendjes se dobët ekonomik (me ndihmë sociale), me numër personal ..., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës,
- A. B.** nga babi R. dhe nëna R., mbiemri i vajzërisë se nenës N. i lindur më ... në B. komuna e P., ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike (me ndihmë sociale), me numër personal ..., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës,

J A N Ë F A J T O R Ë

Sepse:

Me datë 26.09.2024, rreth orës 13:00, në fshatin B. komuna e P. të pandehurit me qëllim të vjedhjes së trungjeve në pyllin i cili është prone e Korporatës energjetike te Kosovës (KEK-ut) afër liqenit te B. kishin shkuar dhe kane prerë dru te llojit Qarr Bung dhe Shkozë me një motosharrë te tipit STHL më pas i kishin bart me mjetë për bartje Rimorkio i cili ishte i lidhur me një traktor të tipit Marsei pa tabela të regjistrimit duke u takua në rojën e pyllit i cili e kishte lajmërua rastin në polici kështu që i kanë shkaktuar dëm pronësor KEK –ut duke prerë drunjtë rreth 3.00meter cub me vlerë prej 335.00euro.

- me këtë kanë kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 1 të KPRK-së

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe neni 349 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 364, 365, 368, 369, 449, 452 dhe 461 të KPPRK-së, i:

G J Y K O N

I. Të akuzuarit secilin veç e veç me dënim me gjobë në shumë nga **150.00 (njëqind e pesëdhjetë/€uro)**, të cilat dënime janë të obliguar t'i paguajnë në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

II. Të pandehurit lirohen nga shpenzimet e procedurës penale, për arsye se të njëjtit janë të gjendjes së dobët ekonomike dhe se pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të pandehurve ose të personave që ata detyrohen ti mbështesin materialisht.

IV. Detyrohen të akuzuari që të dëmtuarës KEK-ut-, t'ia kompensojnë dëmin material në vlerë prej 335.00 Euro, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm , ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.5333/2024 të dt.29.11.2024, kundër të akuzuarve A. B. dhe A. B., për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka treguar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më dt.06.01.2025, në të cilën prezantuan Prokurori e Shtetit Dardan Çela nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, përfaqësuesit të palës së dëmtuar B. K. dhe të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar i akuzuari A. B. deklaroi: Se e pranoj fajësinë, drunjtë i kam prerë për të mbajtur familjen, nuk kam mundësi për të i blerë, është hera e parë që jam në gjykatë, e lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë jetoj me ndihmë sociale.

I akuzuari A. B. në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi: se e pranoj fajësinë, është e vërtetë se me A. kemi qenë në pyll dhe na ka takuar roja e pyllit, unë kam shkuar për të ia marr drunjtë A. me traktor, i premtoj gjykatës se ky rast më nuk do të përsëritet asnjëherë, e lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë, jetojmë me ndihmë sociale.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: e mbështesin në tersi aktakuzën e prokurorit të shtetit dhe kërkojmë që të pandehurit të shpallen fajtor sipas veprës së paraqitur në aktakuzë, kërkojmë nga gjykata që të pandehurit të i obligoj për kompensimin e dëmit në vlerë prej 335€.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit Dardan Çela lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve deklaroi: Nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë sepse i njëjti është bërë konform dispozitave ligjore, të pandehurit e kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë me vullnetin e tyre, pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës, andaj i propozojmë gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë, të njëjtit t'i shpallë fajtorë dhe t'i dënoj sipas ligjit, gjithashtu ndaj të njëjtëve të shqiptoi dënimin plotësues të i urdhëroi për kompensimin e humbjes apo dëmit siç e parasheh neni 59 dhe 69 i KPRK-së ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merren parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese. Si rrethanë rënduese të merret shkalla e lartë e dashjes për të kryer veprën penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, faktin se vepra penale është kryer në bashkryerje ndërsa si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë para kësaj gjykate.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.2 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhja e Pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se të akuzuarit në aspektin penal-juridik janë përgjegjës, për çka edhe u shpallën fajtorë dhe i,u shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me neni 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se të akuzuarit në shqyrtimin fillestar e kanë pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila u vihet në barrë, kanë premtuar se më nuk do ta përsërisin veprën, janë të gjendjes së dobët ekonomike, jetojnë me ndihmë sociale ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, andaj gjykata duke i vlerësuar këto rrethana ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tyre, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me neni 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 pika 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi lirimin nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të KPRK-së.

Vendimi mbi obligimin për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar është marrë konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.468/24, me dt.06.01.2024

Sekretare Juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.